

**Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit****Nr.07/351-15174****Dt.30.06.2017**

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Driton (Sadri) Hasi** nga Gjakova, për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, me afarizëm në përdhese – FAZA E PARË, me etazhitet për fazën e parë B+P+1, ndërsa etazhiteti i përgjithshëm i objektit B+P+4, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET: Driton (Sadri) Hasi nga Gjakova, ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, me përdhese – FAZA E PARË, Sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Rregullues Urban të potezit përgjatë rrugës “Dëshmorët e Lirisë” dhe Kushtet Ndërtimore me nr. 07/351/01-50386, të datës 05.06.2017, të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 5793/0, ZK: Gjakovë - Qytet, në pronësi të lartë përmendurit, në rrugën “Dëshmorët e Lirisë”, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, **etazhiteti i objektit për FAZËN E PARË është B+P+1**, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) te objektit për këtë fazë **S=1633.16 m²**

Bodrumi: (Sip.Bruto): **S=547.00 m²**
Përdhesa: (Sip,Bruto): **S=479.08 m²**
Kati i parë: (Sip,Bruto): **S=607.08 m²**

II. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, me afarizëm në përdhese, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë byroja projektuese “LLA”SH.P.K. - Gjakovë.

III. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

IV. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

V. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

Arsyetim

Driton (Sadri) Hasi nga Gjakova, me banim në rrugën “Dëshmorët e Lirisë”, nr. 152 ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351-15174, dt. 16.06.2017, për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, me afarizëm në përdhesë – FAZA E PARË, me etazhitet për fazën e parë B+P+1, ndërsa etazhiti i përgjithshëm i objektit B+P+4, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 5793/0, ZK: Gjakovë - Qytet, në pronësi të lartë përmendurit, në rrugën “Dëshmorët e Lirisë” siç është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:1 000 , të datës 05.06.2017, i punuar nga SHPK “GEO-REJ”- Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 16.05.2017, në pronësi të Driton (Sadri) Hasi, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme(fotokopje) me nr. të lëndës 2522/17, të datës 16.05.2016, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Kushtet Ndërtimore për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit banimor shumë banesor në me afarizëm në përdhesë, me nr. 351/01-50386, në ngastrën kadastrale me nr. 5793 :ZK: Gjakovë-Qytet, me të datës 05.06.2016.
5. Raporti mbi kërkimet gjeomekanike në teren si dhe kërkimet laboratorike në lokacionin e parashikuar për ndërtimin e objektit afaristo banesor, me Investitor Driton Hasi nga Gjakova, në ngastrën kadastrale me nr. 5793/0, të hartuar nga “Geomerkur” Sh.p.k.Gjakovë.
6. Lejen Mjedisore Komunale me nr. 07-351/1 - 14380, dt.29.06.2017, lëshuar nga DUMM.
7. Pëlqimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, me nr. 08-320/01-14655 e dt.08.06.2017, nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, komuna e Gjakovës.
8. Pëlqimin Sanitar, me nr 14/53/11930 të datës 07.06.2017, nga Inspektoriati Sanitar komunal-Drejtoria për Punë Inspektuese.
9. Pëlqimin për lokacion nga mbrojtje kundër zjarrit, me nr.93/17 me datë 16.05.2017, lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent, Ministria e Punëve të Brendshme e R.K.S.
10. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr 430-C-222 të datës 05.02.2017.
11. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, dt. 28.04.2012.
12. Pëlqimin nga K.R.U.”Radoniqi”Sh.A.-Gjakovë, me nr.855, dt.24.03.2017.
13. Pëlqimin nga PTK- Sh.A. Gjakovë, të datës 24.03.2016.
14. Vërtetimin nga KRM”ÇABRATI”, me nr.,545, dt.13.06.2017.
15. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Bankën për Biznes, filiali në Gjakovë, të datës 23.05.2017.
16. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, i punuar nga byroja projektuese “LLA”SH.P.K. - Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 5123.90 Euro.


KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.


Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspektionit ,
- Arkivës.

Zyrtar i Lartë për Çështje Juridike


Zenel Shabani, jur.dipl.

U.D. Drejtori


Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT \ KOPIJA PLANA \ COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija \ Municipal Cadastral Office : GJAKOVË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona \ Cadastral Zone : Gjakovë Qytet

Njësia \ Jedinica \ Unit	Tipi \ Vrsta \ Type	Sipërfaqja \ Poveršina \ Area m ²
P - 70705029 - 05793 - 0	Parcelë \ Parcela \ Parcel	1124.0



Shkalla / Razmera /Scale: 1:500

Punoi \ Obradio \ Created :
Data \ Data \ Date : 16.05.2017
Koha \ Vreme \ Time : 13:38:17
Nënshkrimi \ Potpis \ Siganture:
Shënim \ Beleška \ Note :

Aprovoi \ Usvojio \ Approved \ Drejtori \ Direktor \ Director
Nënshkrimi \ Potpis \ Siganture:

